



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR  
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR KORÇË

Nr.27 Prot.

Korçë, më 08.01.2024

**SHPALLJE E PROCEDURAVE TË KONKURRIMIT PËR DREJTUES NË  
INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE**

Në mbështetje të nenit 55 të Ligjit 69/2012 datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 1, nenit 2 dhe nenit 3 të Udhëzimit Nr. 22, datë 13.11.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave të emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit dhe nëndrejtorit të institucionit publik arsimor parauniversitar” si dhe Urdhërit Nr 01. dt 08.01.2024 të DRAP Korçë “Për hapjen e procedurave të konkurrimit për pozicionet vakante drejtor institucioni arsimor publik”.

1. Shpallen procedurat e konkurrimit për pozicionin drejtues institucioni arsimor në institucionet arsimore publike, sipas tabelës bashkëlidhur.

**Kushtet që duhet të plotësojë kandidati për të aplikuar për pozicionin drejtues institucioni publik arsimor parauniversitar:**

- Të zotërojë arsimim si mësues sipas përcaktimeve të nenit 57 të ligjit 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
- Të ketë të paktën kategorinë “Mësues i kualifikuar” me vlerësim jo më pak se “Mirë” në kualifikimin e fundit.
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi ndaj tij.

**Dokumentacioni i aplikimit për pozicionin e drejtorit në institucionin publik arsimor parauniversitar:**

- Jetëshkrimin (sipas modelit në shtojcën nr. 1 të Udhëzimit nr. 22, datë 13.11.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave të emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit dhe nëndrejtorit të institucionit publik arsimor parauniversitar”);
- Kopje e librezës së punës;
- Kopje e dokumentit të identifikimit (ID);
- Tabelën me të dhënat për aplikantin (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 5 të udhëzimit);
- Certifikatën e drejtuesit të IPAP-së ose vërtetim nga Shkolla e Drejtorëve që është pranuar për të kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor, në rast se e disponon;
- Vetëdeklarim i gjendjes gjyqësore (sipas modelit të përcaktuar në shtojcë nr. 2 të udhëzimit);
- Vërtetim nga institucioni ku punon, që aplikanti nuk ka masë disiplinore në fuqi.

- Deklaratën për verifikimin e vërtetësinë të dokumentacionit të paraqitur nga kandidati sipas shtojcës 8, të udhëzimit.
- Deklaratën e konfliktit të interesit të aplikantit me punonjësit arsimorë të IPAP-së, (bashkëshort/bashkëshorte, prind, vëlla/motër, fëmijë në moshë madhore, prind të bashkëshortit/es), (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 3 të udhëzimit).

Dokumentacioni i mësipërm dorëzohet nëpërmjet **shërbimit postar ose në rrugë elektronike në adresën e ZVAP që mbulon institucionin arsimor ku është shpallur vendi vakant.**

**Dokumentacioni dorëzohet brenda datës 18.01.2024 (brenda 10 ditëve kalendarike nga dita e shpalljes).**

Komisioni i shqyrtimit të dokumentacionit mblidhet jo më vonë se 3 (tri) ditë pune nga përfundimi i afatit të dorëzimit të dokumentacionit të aplikimit, për të bërë shqyrtimin paraprak të dokumentacionit.

Komisioni shqyrton dokumentacionin për mangësi brenda 2 (dy) ditëve pune dhe njofton me shkrim ose e-mail kandidatin që ka mangësi në dosje.

Kandidati nga momenti i njoftimit, ka 3 (tri) ditë pune kohë për të dorëzuar dokumentacionin që mungon.

Pas përfundimit të këtij afati, komisioni shpall listën me kandidatët që kanë dokumentacionin e plotë dhe të saktë, bën vlerësimin e dosjeve si dhe realizon intervistën e strukturuar brenda 1 (një) ditë pune.

Komisioni harton tabelat e pikëve dhe rendit kandidatët sipas shumës së përgjithshme të pikëve, në rendin zbritës dhe brenda 3 (tri) ditëve pune shpall në këndin e njoftimeve të IPAP-së tabelat e pikëve totale të secilit kandidat, sipas shtojcës nr. 7, bashkëlidhur Udhëzimit.

Kandidatët kanë të drejtë të paraqesin ankim me shkrim para komisionit brenda 3 (tri) ditëve pune nga shpallja e rezultateve të konkurrimit. Komisioni shqyrton ankesat brenda 1 (një) dite pune.

Në rast se nuk konstatohen probleme procedurale, drejtori i ZVAP brenda 2 (dy) ditëve pune nga dorëzimi i dokumentacionit të plotë nga Komisioni, përcjell në DRAP dokumentacionin e dy kandidatëve me më shumë pikë.

Drejtori i DRAP realizon intervistat brenda 5 (pesë) ditëve pune nga momenti i marrjes dijeni të dy kandidatëve me më shumë pikë.

Brenda 3 (tri) ditëve pune, nga realizimi i intervistës me kandidatët, drejtori i DRAP shpall vendimin për kandidatin fitues për pozicionin e drejtorit të IPAP-së.

Kandidati jofitues ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda 3 (tri) ditëve pune në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit. Kandidati ankimues merr përgjigje nga Ministria e Arsimit dhe Sportit brenda 10 (dhjetë) ditëve pune pas mbarimit të afatit të ankimimit.

**Bashkëlidhur këtij njoftimi do të gjeni vendet vakante për pozicion drejtor IAP Publik.**

**DREJTOR I DRAP KORÇË**

**VINJOLA ROTA**





Nr	Drap	Zvap	Bashkia	Emri i institucioni publik arsimor parauniversitar
1	Korçë	Belsh	Belsh	Dragot
2	Korçë	Belsh	Belsh	Fierzë
3	Korçë	Berat	Berat	"Shaban Sollaku" Moravë
4	Korçë	Berat	Berat	28 Nëntori
5	Korçë	Berat	Berat	Mehmet Ali Vrioni
6	Korçë	Berat	Berat	Paftal
7	Korçë	Cërrik	Cërrik	Shkolla E Mesme E Bashkuar "Osman Gjini" Mollas
8	Korçë	Cërrik	Cërrik	Miranda Baku
9	Korçë	Cërrik	Cërrik	Selim Asllani
10	Korçë	Devoll	Devoll	Jorgo Plaku Hoçisht
11	Korçë	Dimal	Dimal	Shkolla 9-Vjeçare "5 Maji" Ure Vajguore
12	Korçë	Dimal	Dimal	Shkolla E Mesme E Bashkuar" Refat Bani" Syzez(Zva Ura Vajguore)
13	Korçë	Dimal	Dimal	Shkolla 9-Vjeçare "Sali Gjuka"
14	Korçë	Dimal	Dimal	Shkolla 9-Vjeçare Drenovicë
15	Korçë	Elbasan	Elbasan	Gjimnazi "Vasil Kamami", Elbasan
16	Korçë	Elbasan	Elbasan	Gjimnazi "Mahir Domi", Elbasan
17	Korçë	Elbasan	Elbasan	Shkolla 9-Vjeçare "Qemal Haxhihasani 1", Elbasan
18	Korçë	Elbasan	Elbasan	Shkolla 9-Vjeçare "Qemal Haxhihasani 2", Elbasan
19	Korçë	Elbasan	Elbasan	Shkolla 9-Vjeçare "Xhaferr Hakani", Elbasan
20	Korçë	Elbasan	Elbasan	Shkolla E Mesme E Bashkuar Gjinar
21	Korçë	Elbasan	Elbasan	Gjimnazi "Anastas Çakalli", Kuqan
22	Korçë	Elbasan	Elbasan	Shkolla 9-Vjeçare Kuqan
23	Korçë	Elbasan	Elbasan	Shkolla 9-Vjeçare Hajdaran
24	Korçë	Elbasan	Elbasan	Shkolla 9-Vjeçare "Sulë Misiri", Elbasan
25	Korçë	Elbasan	Elbasan	Shkolla 9-Vjeçare Shilbater
26	Korçë	Elbasan	Elbasan	Shkolla 9-Vjeçare "Jonuz Carciu", Tregan
27	Korçë	Gramsh	Gramsh	Afez Berbiu Kodovjat
28	Korçë	Gramsh	Gramsh	Xhile Liçi Skenderbegas
29	Korçë	Gramsh	Gramsh	35 Vjetori i Çlirimit
30	Korçë	Korçë-Pustec	Korçë-Pustec	"Sevasti Qirjazi"
31	Korçë	Korçë-Pustec	Korçë-Pustec	Themistokli Gërmenji
32	Korçë	Korçë-Pustec	Korçë-Pustec	Stavri Themeli
33	Korçë	Korçë-Pustec	Korçë-Pustec	Shkolla 9- Vjecare "Dr.Haki Mborja"
34	Korçë	Korçë-Pustec	Korçë-Pustec	Voskopoje
35	Korçë	Korçë-Pustec	Korçë-Pustec	Shkolla 9-Vjeçare Bulgarec
36	Korçë	Kuçovë	Kuçovë	Aleksandër Markaçini Havaleas
37	Korçë	Kuçovë	Kuçovë	Koço Korçari
38	Korçë	Kuçovë	Kuçovë	18 Tetori
39	Korçë	Kuçovë	Kuçovë	Perondi
40	Korçë	Kuçovë	Kuçovë	Myrteza Kepi
41	Korçë	Maliq	Maliq	Shmb "Tafil Rexhepi", Pirg
42	Korçë	Maliq	Maliq	Nefail Rozani
43	Korçë	Maliq	Maliq	Bardhyl Pojani
44	Korçë	Maliq	Maliq	Dhimitraq Gjata

45	Korçë	Përrenjas	Përrenjas	Dilaver Nezha Qukes
46	Korçë	Përrenjas	Përrenjas	Rrajce-Fushë
47	Korçë	Përrenjas	Përrenjas	Qybra Sokoli
48	Korçë	Pogradec	Pogradec	Muhamer Dhe Esat Minarolli
49	Korçë	Pogradec	Pogradec	Kozma Gj. Basho
50	Korçë	Pogradec	Pogradec	Shefki Muçllari
51	Korçë	Pogradec	Pogradec	Dëshmorët E Pojskës
52	Korçë	Pogradec	Pogradec	Selim Gjona
53	Korçë	Skrapar	Skrapar	Ramiz Aranitasi Corovode
54	Korçë	Skrapar	Skrapar	Zylyftar Veleshnja
55	Korçë	Librazhd	Librazhd	"Kasem Zika" Prevall